

RAPORT KËRKIMOR VLERËSUES

“KRIJIMI I BESIMIT NË MEDIA
NË EVROPËN JUGLINDORE
DHE TURQI, FAZA E II-TË”



2022

RAPORT KËRKIMOR VLERËSUES

“KRIJIMI I BESIMIT NË MEDIA NË EVROPËN JUGLINDORE DHE TURQI, FAZA E II-TË”

Projekt i zbatuar nga Instituti Shqiptar i Medias (ISHM)
me mbështetjen e UNESCO-s dhe Bashkimit Evropian

Ky raport është porositur nga Instituti Shqiptar i Medias dhe realizuar nga ekspertet (sipas alfabetit) Blerjana Bino dhe Irida Agolli në kuadër të vlerësimit të projektit “Krijimi i besimit në media në Evropën Juglindore dhe Turqi, faza e II-të” me mbështetjen e UNESCO-s dhe Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij raporti reflekton gjetjet dhe të dhënat e studimit kërkimor dhe të autorëve, jo domosdoshmërisht të Institutit Shqiptar të Medias, UNESCO-s apo Bashkimit Evropian.

© Instituti Shqiptar i Medias

Botues:



Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: info@institutemedia.org

www.institutemedia.org

Nëntor 2022

FALENDERIME

Realizimi i këtij studimi nuk do të ishte i mundur pa bashkëpunimin e shkëlqyer të skuadrës së projektit në Institutin Shqiptar të Medias dhe angazhimin e pakushtëzuar të ekspertëve, mentorëve, drejtorëve të shkollave të përfshira dhe mësuesve.

Falenderojmë të gjithë mësuesit dhe nxënësit që plotësuan pyetësorët, mentorët dhe drejtorët e shkollave që iu përgjigjen ftesës për realizimin e intervistave. Falenderojmë skuadrën e projektit për lehtësimin e të gjithë procesit.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Projekti “Krijimi i besimit në media në Evropën Juglindore dhe Turqi, Faza II” synon të rrisë aftësitë e të rinjve për Edukimin për Media dhe Informacion (EMI) përmes integrit të EMI në kurrikulën e sistemit arsimor parauniversitar formal në Shqipëri. Sipas UNESCO-s, Edukimi për Median dhe Informacionin kuptohet gjerësisht si një grup kompetencash që fuqizojnë qytetarët për të aksesuar, vlerësuar dhe përdorur informacionin në mënyrë kritike.

Në projekt janë përfshirë 20 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, nga qytetet e Tiranës (14), Durrësit (2), Elbasanit (2) dhe Lezhës (2). Fillimisht është hartuar draft-kurrikula e EMI dhe modulet për trajnimin e mësuesve, të cilat janë bërë në bashkëpunim me ekspertët e ASCAP dhe mësuesit e shkollave përkatëse. Trajnimi është ofruar për 240 mësues, por në disa prej tyre kanë marrë pjesë edhe drejtuesit e shkollave. Më pas është punuar me mentorimin e mësuesve për pilotimin e integrit të EMI-t në kurrikulat e lëndëve të ndryshme në arsimin parauniversitar.

Ky raport kërkimor paraqet një analizë të rezultateve të arritura mbi edukimin për median dhe informacionin në 20 shkollat pilot ku është zbatuar projekti, mbështetur kryesisht në perceptimet e mësueve dhe nxënësve, që janë angazhuar në aktivitetet e projektit.

Studimi përdor një qasje të kombinuar të metodës sasiore dhe cilësore. Sa i takon kampionit, i janë përgjigjur pyetësorit 170 mësues (57.1% japin mësim në shkollë të mesme të përgjithshme dhe 42.9% në shkollë 9-vjeçare) dhe 973 nxënës (70% kanë qenë nga shkolla të mesme të përgjithshme dhe 30% nga shkollat 9-vjeçare). Janë zhvilluar intervista të thelluara me 7 mësues, 4 drejtues shkolle, 3 mentorë, një përfaqësues të ASCAP dhe një përfaqësues të ISHM. Janë analizuar gjithashtu dokumente dhe raporte të projektit.

Pjesëmarrësit në studim raportojnë se EMI është shumë i rëndësishëm për shkollën, nxënësit dhe mësuesit. 52% e nxënësve që i janë përgjigjur pyetësorit konfirmojnë se EMI është shumë i rëndësishëm për ta dhe 44.1% e mësuesve mendojnë se është shumë i rëndësishëm. Rreth 38% e nxënësve konfirmojnë se EMI i ka ndihmuar në lëndë mësimore dhe rreth 46% në jetën e përditshme. Projekti krijoi një të kuptuar shumë më të qartë dhe gjithëpërfshirës duke ndihmuar mësuesit dhe nxënësit që të zhvillojnë forma të reja të kompetencave (njohuri, aftësi dhe qëndrime), të zotërojnë aftësitë bazë për të menduarit kritik, për t'u shprehur dhe për të marr pjesë në mënyrë aktive në procesin edukativ. 40% e nxënësve mendojnë se mësuesit duhet të

trajnohen që të përfshijnë EMI-n në programet mësimore në mënyrë që të rinjtë dhe bashkëmoshatarët e tjerë të aftësohen rreth EMI-t.

Progresi pas marrjes pjesë në kursin e EMI-t në këtë projekt konfirmohet qartazi nga 74.7% e mësuesve të pyetur, të cilët konfirmojnë që tashmë kanë shumë informacion për EMI. Gjithashtu, përdorimi i elementëve të EMI-t në procesin e mësimdhënies pas ndërhyrjes së projektit është shtuar: 26% e mësuesve konfirmojnë që e përdorin gjithmonë EMI-n në mësimdhënie dhe 66% e përdorin shpesh. Thujse 100% pohojnë se kanë planifikuar objektiva mësimore që lidhen me përdorimin e medias pas ndërhyrjes së projektit.

Sa i takon mentorimit, 97.1% e mësuesve e vlerësojnë që ka qenë ndihmues për të kuptuar më shumë integrimin e EMI-t në orën e mësimit. 50.6% e mësuesve konfirmojnë që trajnimet e EMI-t duhet të ofrohen për të gjithë mësuesit dhe 31.2% mendojnë se mësuesit duhet të përfshihen në trajnime të vazhdueshme për rritjen e kompetencave në këtë fushë.

Sa i takon sfidave për integrimin e EMI-t në kurrikulën e arsimit parauniversitar, rreth 30% e mësuesve konfirmojnë se planifikimi i veprimtarive të veçanta, që synojnë të vëzhgojnë arritjet e nxënësit në procesin e të nxënësit ka qenë sfida kryesore, ndërsa rreth 22% pohojnë se sfida tjetër kryesore ka qenë planifikimi i veprimtarive konkrete për përfshirjen e nxënësve në detyra që lidhen me EMI-n. Sfidë është edhe pjesa e kushteve në çdo shkollë, infrastruktura e shkollës, kompjuterat, kapacitetet e mësuesve. Mungesa e teknologjisë në shkollë, por edhe në shtëpi për shumë nga fëmijët, e bën të vështirë zbatimin në praktikë të EMI-t në momente të caktuara.

Rekomadime kryesore:

- EMI të bëhet pjesë e një programi të detyrueshëm trajnimi për të gjithë mësuesit, që ta shohin EMI si një mundësi për përgatitjen e nxënësve për rolet e tyre si qytetarë dhe konsumatorë dhe për pjesëmarrje efektive në diskursin demokratik.
- Zhvillimi i vazhdueshëm profesional do të jetë thelbësor për të adresuar ndryshimet dhe zhvillimet në këtë fushë dhe për t'iu përgjigjur me strategjitë e duhura pedagogjike.
- Përdorimi i teknologjisë në orën e mësimit është një nxitës që nxënësit të përfshihen dhe aktivizohen më shumë sesa në rastet kur përdoren format tradicionale të edukimit përmes librit, shkumësit dhe shpjegimit në tabelë të mësuesve.
- Vazhdimësia e projektit dhe mbështetja e shkollave për të zhvilluar edhe dimensionet e tjera të EMI, si mendimin kritik dhe krijimin e përmbajtjeve dhe të shprehurit kërkon një investim më afatgjatë.

- Zhvillimi i një infrasktuture bazë në shkolla, laboratore të medias (që do të përfshinte kompjutera, projektorë, internet, pajisje për regjistrime audio dhe video, biblioteka, etj) me qëllim që nxënësit jo vetëm të marrin informacione, por edhe të zhvillojnë më tej aftësitë dhe kompetencat në fushën e EMI.
- Të krijohet rrjeti profesional i mësuesve për EMI në mënyrë që mësuesit që kanë punuar në EMI-n të mund të vazhdojnë të bashkëpunojnë dhe mësuesit e rinj të gjejnë mbështetje për punën e tyre.

PËRMBAJTJA

FALENDERIME	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
PËRMBAJTJA	5
LISTA E SHKURTIMEVE	9
LISTA E FIGURAVE	10
I. HYRJE	11
1.1 Rreth projektit	11
1.2 Si ta kuptojmë Edukimi për Median dhe Informacionin?	11
1.3 Qëllimi dhe qasja e studimit	12
1.4 Struktura e raportit	12
II. RISHIKIM LITERATURE	13
2.1 Edukimi për Median dhe Informacionin (EMI)	13
2.2 Përfitimet e EMI	15
2.3 Aspektet e EMI	16
2.4 Transferimi i njohurive dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës	17
III. METODOLOGJIA	19
3.1 Instrumentat për mbledhjen e të dhënave	19
3.2 Procesi i mbledhjes së të dhënave	20
3.3 Procesi i analizimit të të dhënave	20
3.4 Pjesëmarrësit / kampioni	20
3.5 Kufizimet e studimit	21

IV. PREZANTIMI I GJETJEVE TË KËRKIMIT	22
4.1 Perceptimet e nxënësve	22
4.2 Perceptimet e mësuesve	26
V. DISKUTIME: ANALIZA E TË DHËNAVE CILËSORE	34
5.1 Rëndësia e EMI në shkollë	34
5.2 Trajnimi i mësuesve	35
5.3 Përfshirja e EMI në orën e mësimit dhe puna me nxënësit	37
5.4 Mentorimi	39
5.5 Sfidat në integrimin e EMI-t në kurrikulat mësimore	40
VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	41
6.1 Mësimet e nxjerra	41
6.2 Praktika të mira	41
6.3 Rekomandime	42
REFERENCA	44
SHTOJCA	45
PYETËSOR PËR NXËNËSIT	45
PYETËSOR PËR MËSUESIT	57
GUIDË PËR INTERVISTA GJYSMË TË STRUKTURUARA	50

LISTA E SHKURTIMEVE

- ASCAP – Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
- BE – Bashkimi Evropian
- EMI – Edukimi për Median dhe Informacionin
- ISHM – Instituti Shqiptar i Medias
- TIK – Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Niveli i shkollës – Nxënësit	22
Figura 2: Klasa e nxënësve	22
Figura 3: Gjinia e nxënësve	23
Figura 4: Qyteti	23
Figura 5: Informacioni për EMI para projektit	24
Figura 6: Njohuri të përfituara nga nxënësit pas realizimit të aktiviteteve	24
Figura 7: Aftësitë EMI të përfituara nga nxënësit	25
Figura 8: Rëndësia e EMI-t	25
Figura 9: Perceptimet e nxënësve përse u ka shërbyer EMI	25
Figura 10: Sugjerimet e nxënësve për EMI-n për të rinjtë e tjerë	26
Figura 11: Përkatësia e mësuesve sipas shkollës	26
Figura 12: Përkatësia sipas gjinisë	27
Figura 13: Qyteti	27
Figura 14: Lënda	28
Figura 15: Informacioni për EMI përpara projektit	28
Figura 16: Informacioni për EMI pas marrjes pjesë në kursin EMI	29
Figura 17: Aplikimi i EMI në mësimdhënie përpara projektit	29
Figura 18: Përdorimi i EMI-t në mësimdhënie pas pjesëmarrjes në projekt	29
Figura 19: Ndihmesa e projektit në aftësitë e mësuesve	30
Figura 20: Objektiva mësimore që lidhen me EMI-n para dhe pas projektit	40
Figura 21: Objektivat mësimorë të lidhur me median	31
Figura 22: Sfidat për integrimin e EMI-t në kurrikulën e arsimit parauniversitar....	31
Figura 23: Sfidat në procesin mësimor me fëmijet lidhur me EMI-n	32
Figura 24: Vlerësimi i mentorimit sipas mësuesve	32
Figura 25: Përfitimet e nxënësve sipas mësuesve	32
Figura 26: Qëllimi i përdorimit të EMI-t për nxënësit sipas mësuesve	33
Figura 27: Rëndësia e EMI-t sipas mësuesve	33
Figura 28: Mendimi i mësuesve për zhvillimin profesional lidhur me EMI-n	34

I.HYRJE

Ky kapitull paraqet një vështrim të përgjithshëm të projektit “Krijimi i besimit në media në Evropën Juglindore dhe Turqi, Faza e II-të” (në vazhdim projekti) që zbatohet nga Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) me mbështetjen financiare të UNESCO-s dhe Bashkimit Evropian (BE). Gjithashtu, paraqitet shkurtimisht edhe qëllimi i këtij studimi dhe qasja e përzgjedhur së bashku me strukturën e raportit.

1.1 Rreth projektit

Projekti “Krijimi i besimit në media në Evropën Juglindore dhe Turqi, Faza II” synon të rrisë aftësitë e të rinjve për Edukimin për Media dhe Informacionin (EMI) përmes futjes së EMI-t në sistemin arsimor formal në Shqipëri. Projekti është zbatuar gjatë periudhës 2020 – 2022 dhe objektivi kryesor ka zhvillimin e njohurive dhe kompetencave EMI të të rinjve në Shqipëri, përmes pilotimit të kurrikulës EMI në arsimin formal.

Ky projekt kontribuon në sektorin e arsimit, siç është priorizuar në Instrumentin e Para-Aderimit II, nëpërmjet përmirësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave të nxënësve dhe mësuesve për edukimin mediatik dhe të informacionit. Në të njëjtën kohë, rritjen e cilësisë së sistemit të arsimit dhe trajnimit, si dhe forcimin e bashkëpunimit midis qeverisë qendrore dhe vendore dhe shoqërisë civile përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse.

1.2 Si ta kuptojmë Edukimin për Median dhe Informacionin?

Me zhvillimet e gjithëanshme teknologjike dhe digjitalizimin, përkufizimit tradicional të edukimit për median i është bashkuar edhe “informacioni” duke e shndërruar kështu në një koncept më gjithëpërfshirës: Edukimi për Median dhe Informacionin. Sipas përkufizimit të mirëpranuar të UNESCO-s, EMI është një tërësi kompetencash (njohuri, aftësi dhe qëndrime) të domosdoshme për jetën dhe punën në shoqërinë e sotme. Edukimi për Median dhe Informacionin përfshin të gjitha llojet e mediave dhe ofruesve të informacionit, sikurse janë libraritë, bibliotekat, arkivat, muzetë, por edhe informacionin e marrë nëpërmjet internetit pavarësisht pajisjes ku aksesohet, apo platformës ku merret informacioni. EMI i pajis qytetarët me aftësitë dhe kompetencat për të qenë qytetarë aktive dhe kritikë, që mund të marrin pjesë në jetën shoqërore dhe të formëzojnë demokracinë.

Kompetencat që EMI synon të zhvillojë janë aftësia për të aksesuar dhe lokalizuar burimet e informacionit; aftësia për të përdorur dhe kuptuar median dhe informacionin për ta aplikuar atë në jetën e përditshme; aftësia për të vlerësuar besueshmërinë, saktësinë dhe objektivitetin e burimeve; aftësia për të krijuar dhe prodhuar përmbajtje mediatike dhe informuese; aftësia për të marrë pjesë duke ditur si dhe kur të ndërveprojë me krijuesit dhe edituesit e medias dhe informacionit; aftësia për të kuptuar mënyrën e funksionimit të medias dhe sistemeve të informimit, organizimin e tyre dhe mënyrën e prodhimit të informacionit; aftësia për të njohur, kërkuar dhe mbrojtur median cilësore dhe burimet e informimit.

1.3 Qëllimi dhe qasja e studimit

Qëllimi i raportit kërkimor është mbledhja e evidencave dhe identifikimi i rezultateve të arritura mbi edukimin për median dhe informimin në 20 shkollat pilot ku është zbatuar projekti “Krijimi i besimit në media në Evropën Juglindore dhe Turqi, faza e II-të”.

- Të vlerësojë sesi ka ndihmuar projekti në rritjen e aftësive të të rinjve për edukimin mbi median dhe informacionin (EMI) përmes integritit të kurrikulës së EMI-t të në sistemin edukativ formal në Shqipëri.
- Të evidentohen ndryshimet që ka sjell projekti tek nxënësit dhe mësuesit në fushën e edukimit për median

Studimi përdor një qasje të kombinuar të metodës sasiore (pyetësor me mësues dhe nxënës për matjen e perceptimeve) dhe intervista të thelluara me mentorë, mësues dhe drejtorë të shkollave, si edhe analizë të dokumenteve të projektit.

1.4 Struktura e raportit

Krahas kapitullit hyrës, ky raport ka 4 kapituj të tjerë që paraqesin kuadrin teorik ekzistues për Edukimin për Median dhe Informacionin, metodologjinë dhe instrumentat kërkimore, analizën e gjetjeve dhe mësimet e nxjerra me rekomandimet për të ardhmen.

II. RISHIKIM LITERATURE

Ky kapitull paraqet një përmbledhje të literaturës ekzistuese lidhur me Edukimin për Median dhe Informacionin (EMI), duke u ndalur në konceptin e EMI, përfitimet, dimensionet përbërëse dhe mënyrën sesi termi dhe praktika është zhvilluar.

2.1 Edukimi për Median dhe Informacionin (EMI)

Në epokën digjitale, njohuritë dhe të kuptuarit tonë për botën që na rrethon, si dhe pjesëmarrja jonë në të, në mënyrë të pashmangshme formësohen nga media dhe teknologjia që ne përdorim çdo ditë. Mesazhet mediatike kanë potencialin të ushtrojnë efekte pozitive dhe negative tek konsumatorët. Edukimi për median synon të krijojë përdorues aktivë dhe kompetentë për të dëshifruar dhe prodhuar mesazhe mediatike. Parimi themelor i edukimit për median është procesi i hetimit - zakoni i vënies në pikëpyetje të përmbajtjeve mediatike mbi baza sistematike. "Eshtë shfaqur një kulturë mediatike në të cilën imazhet, tingujt dhe spektaklet ndihmojnë në prodhimin e strukturës së jetës së përditshme, duke dominuar kohën e lirë, duke formësuar pikëpamjet politike dhe sjelljen shoqërore dhe duke ofruar materiale nga të cilat njerëzit krijojnë vetë identitetin e tyre." (Kellner, 1995). Edukimi për median dhe informacionin kuptohet gjerësisht si një grup kompetencash që fuqizojnë qytetarët për të aksesuar, vlerësuar dhe përdorur informacionin në mënyrë kritike (UNESCO, 2013a).

Ekziston një dakordësi që EMI si një term ombrellë fokusohet në angazhimin qytetar në komunikimin dhe format e përmbajtjes (informacion, argëtim, reklamë, çinformim dhe dezinformim, etj.), si ato prodhohen, shpërndahen dhe nga kush; se si njerëzit e përdorin ose jo përmbajtjen; se si ato angazhohen me dhe kuptojnë rëndësinë dhe mënyrën e veprimit të bibliotekave, ofruesve të mediave dhe komunikimeve dixhitale, ose mungesës së tyre; me cilat njohuri, aftësi dhe mendësi qytetarët vlerësojnë në mënyrë kritike përmbajtjen; dhe se si njerëzit menaxhojnë ndërveprimin e tyre në mënyrë që të dallojnë dhe përcaktojnë angazhimin e tyre me informacionin dhe llojet e tjera të përmbajtjes, medias dhe instrumenteve të komunikimit dixhital që të arrijnë rezultatet të dëshiruara në jetët personale, shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore (UNESCO, 2019).

Në vitin 2011, UNESCO ndërmori një hap të rëndësishëm në fushën e EMI duke prezantuar një kurrikul EMI për mësuesit, e cila do t'u mundësonte mësuesve të

zhvillojnë një kuptim më të madh të rolit të medias dhe teknologjisë së informacionit, në jetën e tyre dhe në jetën e nxënësve të tyre. Kurrikula EMI e përkufizon edukimin për median dhe informacionin si “kompetenca thelbësore (njohuri, aftësi dhe qëndrime) që u mundësojnë qytetarëve të angazhohen në mënyrë efektive me mediat dhe ofruesit e tjerë të informacionit për të zhvilluar të menduarin kritik dhe aftësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës me synimin për t’u socializuar dhe për t’u bërë qytetarë aktivë». EMI merret me procesin e të kuptuarit dhe përdorimit të mediave e ofruesve të tjerë të informacionit, si dhe me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. EMI ka si qëllim që të ndihmojë mësuesit dhe nxënësit që të zhvillojnë një kuptim të informuar dhe kritik se si funksionojnë mediat dhe teknologjitë e ndryshme, si mund të përdoren, si e organizojnë informacionin, si të krijojnë kuptim dhe si të vlerësojnë informacionin që ata paraqesin. EMI gjithashtu përfshin përdorimin etik të medias, informacionit dhe teknologjisë, si dhe pjesëmarrjen në dialogun demokratik dhe ndërkulturor (Wilson, 2012).

Studimet tregojnë sesa i rëndësishëm është edukimi mediatik si një mënyrë për të ndihmuar nxënësit të fitojnë kompetencat që u nevojiten për jetën dhe punën në një botë të varur nga media. Këto kompetenca përfshijnë aftësinë për të aksesuar, kërkuar, analizuar dhe vlerësuar përmbajtjen dhe informacionin e medias, si dhe përdorimin e mediave dhe teknologjive për të ndarë informacionin dhe për të treguar historitë e tyre. Mësimdhënia dhe të nxëniet e edukimit mediatik përfshin eksplorimet e tre fushave kryesore: prodhimi i medias si nga industritë e medias, ashtu edhe nga përdoruesit e medias; tekstet mediatike dhe mjediset ose platformat e lidhura në rrjet, duke përfshirë mënyrën se si mesazhet dhe informacionet mund të përcillen dhe shpërndahen; dhe audiencat e medias duke shpjeguar se si ata mund të targetohen, si reagojnë dhe si i përdorin në mënyrë aktive mediat dhe teknologjitë. Edukimi mediatik ka të bëjë me ndihmën që iu ofrohet nxënësve që të zhvillojnë një kuptim të informuar dhe kritik të të gjitha formave të medias dhe teknologjive të ngjashme, duke përfshirë ndikimin dhe përdorimin e tyre të mundshëm. Për shumë edukatorë, kompetencat e edukimit mediatik lidhen drejtpërdrejtë me të drejtat demokratike, qytetarinë aktive dhe aftësimin teknologjik.

Neni 19 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut pohon se “Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe ndarjes të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti, në është e nevojshme, edhe pa marrë parasysh kufijtë”. EMI i lejon njerëzit të kuptojnë më mirë format e ndryshme të mediave dhe ndikimin e tyre në shoqëri. Ai rrit ndërgjegjësimin e njerëzve për kulturën, vlerat e tyre, rëndësinë e informacionit dhe komunikimit. Sistemet mediatike, shoqëritë dhe qeniet njerëzore individuale janë komplekse dhe të shumëanshme. Kjo është arsyeja pse njerëzit e aftësuar me median dhe burimet e informacionit shmangin gjykimet e shpejta dhe të thjeshtuara. Një objektiv tjetër i EMI është mundësimi i aksesit më të madh në media dhe lehtësimi i njerëzve që të krijojnë përmbajtjen

e tyre. Kjo mund të krijojë vizione të reja për aksesin, strukturën dhe kontrollin e medias, si edhe të zhvillojë një shoqëri ku njerëzit vlerësohen si qytetarë dhe nuk trajtohen si subjekte.

Teknologjitë e sotme i lejojnë njerëzit të krijojnë dhe analizojnë mesazhe në një sërë formatesh mediatike si tekst, foto ose video. Por aftësitë e nevojshme për ta bërë këtë duhet të mësohen, praktikohen dhe përditësohen shpesh. Kjo do të thotë të jesh i arsimuar në media dhe përfshin të mësuarit gjatë gjithë jetës. Të rinjtë në veçanti kanë nevojë për mundësi për t'u angazhuar me mësuesit, në mënyrë që ata të kuptojnë përvojat e tyre me mediat masive, si dhe me teknologjitë më të reja, si mediat sociale dhe platformat online.

2.2 Përfitimet e EMI

EMI trajtohet si një parakusht që individët, komunitetet dhe kombet të gëzojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre universale të njeriut dhe liritë themelore, në veçanti: aksesin në informacion, lirinë e shprehjes dhe të drejtën për arsimim, siç artikullohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. EMI është po aq i rëndësishëm për ekzistencën e qeverisjes së mirë, llogaridhënies dhe transparencës në çdo shoqëri, për trajtimin e varfërisë, zhvillimit ekonomik dhe shoqëror (UNESCO, 2013b).

Përfitimet kryesore janë se EMI (UNESCO, 2013a):

- Nxit respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe fuqizon të gjithë qytetarët që të marrin vendime të informuara;
- Ofron një kornizë gjithëpërfshirëse për kultivimin e një mase kritike, mes të gjithë qytetarëve, zhvillimit të kompetencave të shekullit të 21-të që kërkohen për t'iu përgjigjur sfidave, rreziqeve, kërcënimeve dhe mundësive të reja, duke pasur parasysh ndikimin e rëndësishëm të informacionit, medias dhe TIK-ut në sferën e jetës personale, sociale dhe profesionale;
- Ndhmon për të rritur ndërgjegjësimin, mirëkuptimin dhe njohuritë në lidhje me funksionet e mediave dhe ofruesve të informacionit në shoqëritë demokratike; siguron të kuptuarit rreth kushteve të nevojshme për kryerjen e këtyre funksioneve në mënyrë efektive dhe me përgjegjësi;
- Ndhmon qytetarët të fitojnë kompetencat bazë të nevojshme për të aksesuar informacionin dhe përmbajtjen mediatike, për të vlerësuar performancën e mediave dhe ofruesve të informacionit në dritën e funksioneve të pritshme dhe për të krijuar dhe shkëmbyer njohuri në mënyrë efektive dhe etike.
- Ndhmon në rritjen e kompetencave EMI në nivel institucional dhe individual, duke krijuar një mjedis të favorshëm në nivel kombëtar. Anasjelltas, disponueshmëria e kompetencave të EMI rrit kërkesën për një mjedis të

përmirësuar dhe rezultatet e lidhura me të, si përmbajtja, shërbimet dhe produktet e reja, si dhe punësimi, shkëmbimi dhe dialogu ndërkulturor, duke çuar në zhvillim të qëndrueshëm dhe paqe.

- Njohuria mbi median dhe informacionin përmirëson procesin e mësimdhënies dhe të nxënimit të ofruar nga mësuesit për të rinjtë duke i ndihmuar ata të bëhen mendimtarë të pavarur, kritikë dhe reflektues, si dhe punonjës efektivë dhe krijues të njohurive.

Për të shijuar përfitimet e EMI, kërkohen kushtet e mëposhtme (UNESCO, 2013a):

- Një qasje e vetme edukimi ose vetëm arsimimi bazë nuk mbështet dhe përfshin të gjithë aktorët, përfshirë politikëbërësit dhe vendimmarrësit, planifikuesit arsimorë dhe komunitetin profesional.
- EMI duhet të konsiderohet si një tërësi kompetencash të përbëra nga njohuri, aftësi dhe qëndrime.
- Të gjithë qytetarët, duke përfshirë grupet e marginalizuara, të tillë si personat me aftësi të kufizuara, pakicat etnike, duhet të kenë akses të barabartë në informacion dhe njohuri dhe të jenë në gjendje të shprehin veten e tyre.
- Krijimi i një mjedisi mundësues dhe ngritja e kapaciteteve për të gjithë qytetarët në EMI janë thelbësore për ndërtimin e shoqërive të dijes.
- Vëmendje e veçantë kërkohet për ofrimin e trajnimeve EMI për mësuesit të cilët, si edukues të dijes, kontribuojnë ndjeshëm në fuqizimin e qytetarëve të rinj.

2.3 Aspektet e EMI

EMI është rezultati optimal i edukimit të medias, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Megjithatë, kjo ngre pyetjen se cilat rezultate mund të konsiderohen në mënyrë specifike si EMI. Në literaturë mund të dallohen tre opsione: aftësitë teknike, qëndrimet kritike dhe faktet rreth medias dhe TIK-ut.

Aftësitë teknike përfshijnë aftësinë për të aksesuar dhe përdorur kompjuterë, celularë dhe pajisje të tjera teknike që ofrojnë përmbajtje mediatike dhe informacioni. Kurrikula EMI e UNESCO-s (2011) e përcakton këtë aspekt të EMI si “qasje në informacion në mënyrë efektive dhe efikase”. Është e rëndësishme të theksohet se aftësitë teknike janë një parakusht absolut për të qenë në gjendje të zbatoni EMI në praktikë. Në shumë vende, projektet EMI duhet të fillojnë me kurse bazë në Media Dixhitale dhe Informacion.

Aftësitë e dekodimit të përmbajtjes janë të rëndësishme si hapi tjetër. Ato përfshijnë aftësinë për të zbrëthyer dhe analizuar mesazhet mediatike (Mihailidis, 2009), por

gjithashtu njohjen e nevojave të dikujt për informacion dhe aftësinë për t'i kënaqur ato. Një tjetër aftësi është ajo kompozicionale mediatike në modelin e kompetencës mediatike. Kjo përfshin krijimin e llojeve të reja të përmbajtjes mediatike, inkurajimin e vetëvendosjes dhe rritjen e mundësive të individëve për pjesëmarrje. Pra, EMI përfshin padyshim një aspekt praktik/demonstrues, meqë edukimi gjithmonë përfshin kompetencën për të qenë në gjendje të bësh dhe jo thjesht të dish disa gjëra.

Megjithatë, **njohja e fakteve** rreth medias dhe TIK-ut është rezultati ndoshta që lidhet më shumë me shkollën tradicionale dhe arsimin në tërësi. Susan D. Moeller (2009) ka përmbledhur disa aspekte të EMI nga këndvështrimi i përdoruesit, duke argumentuar se konsumatorët e medias duhet të jenë në gjendje të identifikojnë lajmet, të dinë se si media vendos se çfarë ka rëndësi dhe të kuptojnë rolin e medias në formësimin e çështjeve globale. Në mënyrë të ngjashme është vënë në dukje rëndësia e njohjes së funksioneve të brendshme (kontekstet, rutinat, përmbajtjet) dhe efektet e medias.

Nxitja e qëndrimeve të caktuara ndaj medias dhe burimeve të tjera të informacionit përfshin të qenit kritik ndaj efekteve të mundshme negative të medias dhe gatishmërinë për të mbrojtur pozitivisht median kundër burimeve të mundshme të ndikimit. Len Masterman (2003) ka argumentuar se qëllimi i EMI duhet të jetë autonomia kritike, duke u mundësuar "të rinjve të qëndrojnë në këmbët e tyre kritike».

2.4 Transferimi i njohurive dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës

Megenëse EMI është një disiplinë e re dhe në zhvillim, duhet të ofrohen trajnime dhe seminare për të siguruar transferimin e njohurive. Transferimi i njohurive është një qasje për të përmirësuar dhe për të edukuar me informacionet e reja. Transferimi i njohurive mund të fitohet përmes leximit, kërkimit dhe aktiviteteve të tjera të ndërtimit të kapaciteteve. Kjo është një mënyrë për të përcjellë atë që eksperti ka mësuar dhe për ta ndarë atë me ata që janë të interesuar të mësojnë në të njëjtën fushë njohurish. Transferimi i njohurive është gjithashtu një mënyrë për të edukuar ata që kanë më pak përvojë dhe mund të kenë nevojë për drejtim dhe këshillim nga mësuesi ose trajneri. Kjo përkthehet në përvojën e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Analiza e Mahoney (2017) e të mësuarit gjatë gjithë jetës është të mësuarit gjatë gjithë jetëgjatësisë sonë. Për sa kohë që jetojmë, ne duhet të vazhdojmë të mësojmë aftësi të reja dhe të fitojmë njohuri të reja.

Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë mbetet një synim kryesor në një botë ku pothuajse një e pesta e popullsisë globale të fëmijëve nuk është në shkollë. Arsimi cilësor është një nga 17 synimet për të transformuar botën sipas Axtendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, të miratuar nga të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në 2015 (OKB, 2015). UNESCO ka bërë një punë të jashtëzakonshme në trajnimin e mësuesve në media dhe TIK, në lidhje me integrimin e TIK-ut në arsim

si një burim mësimor dhe përfshirjen e edukimit mediatik dhe informacionit në kurrikulën e detyrueshme.

UNESCO sugjeron se është e rëndësishme që EMI të jetë prezent “jo vetëm në politikën arsimore, por edhe në komunikim dhe teknologji, kulturë dhe fusha të tjera të administratës publike” (UNESCO, 2013c). Pavarësisht nga ky trend integrues, edhe në lidhje me trajnimin e mësuesve për në epokën digjitale, UNESCO ka përcaktuar një kuadër të kompetencave të TIK-ut për mësuesit (UNESCO, 2019) dhe, nga ana tjetër, një kurrikulë të edukimit mediatik dhe informacionit edhe për ta (Wilson et al., 2011).

Në vitin 2006, Parlamenti Evropian rekomandoi një sërë aftësish kyçe për të mësuarit gjatë gjithë jetës, një moment historik i rëndësishëm në përcaktimin e një strategjie gjithëpërfshirëse në fushën e arsimit, ku aftësitë përkufizohen si një përzierje e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, që janë të përshtatshme për çdo kontekst të performancës. Aftësitë kryesore thuhet se janë ato që mbështesin përmbushjen personale, përfshirjen sociale, qytetarinë aktive dhe punësimin. Debati u bë shumë interesant pasi disa autorë folën për rëndësinë e përgatitjes së mësuesve për sfidat e shekullit të 21-të, përkatësisht në Evropë, për të vepruar në një shoqëri në ndryshim. Persson deklaroi se “Nëse profesionistët në arsim do të përgatisin një grup edhe më të larmishëm nxënësish për punë shumë më sfiduese, ata do të kenë nevojë në thelb më shumë/njohuri të reja dhe aftësi rrënjësisht të ndryshme gjatë gjithë jetës nga sa kanë shumica tani”. Disa vite më vonë, një studim (Ala-Mutka, 2010) arriti në përfundimin se objektivat e të mësuarit do të fokusohen më shumë në aftësitë sesa në njohuri, se të mësuarit do të përshtatet më shumë me nevojat e jetës reale dhe se individët do të jenë më aktivë dhe më të lidhur me mjedisin e tyre dhe për këtë arsye mësuesit vetë do të bëhen nxënës gjatë gjithë jetës.

Mësuesit janë aktorët kryesorë në një kontekst social në ndryshim, veçanërisht në një shoqëri informacioni. Këto ndryshime kanë ndikim më të madh në të nxënit dhe bazohen pikërisht në shkëmbimin e informacionit dhe në mënyrën e gjenerimit të njohurive, por edhe në mënyrën se si kërkohet, zgjidhet dhe përdoret informacioni. Kjo është arsyeja pse ekspertiza për të trajtuar informacionin është një aftësi jetike për çdo qytetar në shekullin e 21-të, veçanërisht për profesionistët, materiali kryesor i të cilëve është informacioni dhe njohuria.

Praktikat e reja të mësimdhënies dhe të nxënit janë gjithashtu të rëndësishme për këtë reflektim. Mësimdhënia me në qendër nxënësin kërkon përdorimin e burimeve mësimore digjitale dhe të bazuara në multimedia. Bibliotekat dhe pajisjet digjitale lehtësojnë ripërdorimin e përmbajtjes digjitale, duke lejuar aksesin në një sërë burimesh dhe duke nxitur formimin e të menduarit kritik dhe krijimin e ideve më komplekse, duke inkurajuar nxënësit të përdorin burimet dhe t'i riinterpretojnë ato (McGill, 2011).

III. METODOLOGJIA

Ky kapitull paraqet metodat kërkimore të studimit, procesin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave, kampionin, si edhe kufizimet e studimit.

3.1 Instrumentat për mbledhjen e të dhënave

Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij studimi është një kombinim i metodës sasiore dhe asaj cilësore, duke filluar me rishikimin e të gjithëdokumentave të mëparshme ekzistuese (desk review) të projektit (raporte narrative, studime, manuale, raporte mentorimi, etj), si dhe me mbledhjen e informacionit sasior e cilësor në terren, nëpërmjet përgatitjes së instrumentave përkatës. Të dhënat sasiore dhe cilësore u mbledhën në 20 shkollat që ishin pjesë e projektit.

Të dhënat sasiore u mbledhën nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar nga mësuesit dhe nxënësit. Përgatitja e pyetësorit për mbledhjen e të dhënave u bazua në dokumentat e projektit me qëllim eksplorimin e çështjeve që lidheshin me ndërhyrjet e projektit bazuar në kontekstin shqiptar. Fillimisht instrumentat u pilotuan dhe më pas u shpërndanë për mbledhjen e të dhënave.

Pyetësori i mësuesve përfshinte disa çështje si: të dhënat demografike, informacion për EMI para dhe pas projektit, aplikimi i EMI në mësimdhënie përpara dhe pas projektit, ndihmesa e projektit në aftësitë e mësuesve, objektivat mësimore që lidhen me EMI-n para dhe pas projektit, sfidat për integrimin e EMI-t në kurrikulën e arsimit parauniversitar, sfidat në procesin mësimor me fëmijët lidhur me EMI-n, vlerësimi i mentorimit sipas mësuesve, përfitimet e nxënësve sipas mësuesve, qëllimi i përdorimit të EMI-t për nxënësit sipas mësuesve, etj.

Pyetësori i nxënësve përfshinte: të dhënat demografike, informacion për EMI-n para dhe pas projektit, aftësitë EMI të përfituara nga nxënësit, rëndësia e EMI-t, perceptimet e nxënësve përse u ka shërbyer EMI, sugjerimet e nxënësve për EMI-n për të rinjtë e tjerë.

Kombinimi i metodës sasiore me atë cilësore ishte i domosdoshëm pasi raporti kërkimor fokusohet në mbledhjen e evidencave dhe identifikimin e rezultateve të arritura nga projekti. Për të garantuar thellësi dhe gjerësi në eksplorimin e të gjitha perspektivave, u përdor teknika e mbledhjes së të dhënave cilësore, përmes intervistave të thelluara (gjysmë të strukturuar). Gjithsesj u zhvilluan 16 intervista gjysmë të strukturuar.

Pyetjet në intervistat individuale ishin të organizuara në: rezultatet e arritura nga projekti, rëndësia e mentorimit, sfidat kryesore në integrimin e EMI-t në kurrikulat mësimore, mësimet e nxjerra, ndryshimet që kanë vënë re në punën me nxënësit, rekomandimet se çfarë duhet bërë më shumë në fushën e EMI, etj.

3.2 Procesi i mbledhjes së të dhënave

Mbledhja e të dhënave është realizuar gjatë muajit Qershor 2022. Pyetësorët u shoqëruan me një sesion informues mbi qëllimin e studimit dhe gjithë procesin sesi do të analizohen të dhënat dhe ruhet konfidencialiteti. Përpara fillimit të intervistës pjesëmarrësve iu jepej informacion mbi raportin kërkimor, qëllimin e tij dhe theksohej në mënyrë të veçantë ruajtja e konfidencialitetit, si gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, por edhe më pas, gjatë analizimit të tyre. Disa nga intervistat u zhvilluan online dhe pjesa tjetër ballpërball në mjediset e shkollave ose zyrat e profesionistëve, kjo dhe në varësi të mundësive që kishin të intervistuarit.

Me qëllim që pjesëmarrësit të shpreheshin lirshëm, gjatë intervistës nuk u ruajt në mënyrë strikte radha e pyetjeve, me qëllim që intervista të ishte më e natyrshme, duke u fokusuar në çështjet me interes për raportin kërkimor. Gjatë intervistës u bënë edhe pyetje të tjera më qëllim që të merrej informacioni i synuar.

3.3 Procesi i analizimit të të dhënave

Për analizën e të dhënave cilësore u përdor qasja tematike. Të dhënat i janë nënshtruar procesit të transkriptimit dhe konsideratat etike janë respektuar gjatë gjithë procesit të transkriptimit. Pasi ekspertet u njohën me të dhënat duke lexuar dhe rilexuar transkriptin, ato filluan të identifikojnë kodet. Pas identifikimit të kodeve, ka pasur një proces tjetër të leximit të të dhënave, kodeve dhe krijimit të kategorive. Kategoritë u analizuan në marrëdhënie, ndryshime që ndihmuan në krahasimin dhe krijimin e nënkategorive.

Analiza e të dhënave sasiore është bërë përmes excel. Çdo pyetje është ilustruar në përqindje dhe nëpërmjet grafikëve jepet një informacion mbi qëndrimet e të intervistuarve. Të dhënat e marra nga pyetësorët e nxënësve dhe mesuesve janë analizuar të ndara.

3.4 Pjesëmarrësit/ kampioni

Pjesëmarrja e aktorëve të ndryshëm të projektit dhe nxënësve dha një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e raportit të kërkimit. Kjo pjesëmarrje shërbeu për të

integruar njohuritë dhe perceptimet e palëve të interesuara. Në kërkim morën pjesë nxënës, mësues dhe drejtues të shkollave (20 shkollave që ishin pjesë e projektit). Gjithashtu u bënë pjesë të kërkimit edhe përfaqësues nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, si edhe përfaqësues të Institutit Shqiptar të Medias, që kanë zbatuar projektin.

Për realizimin e raportit kërkimor është përdorur metoda sasiore dhe cilësore e kërkimit, ku mbledhja e të dhënave është bazuar në realizimin e pyetësorëve të strukturuar, të administruar online (nëpërmjet Google form) me mësuesit (N=170) dhe nxënësit (N=973), si dhe në realizimin e intervistave online dhe ballpërball ku gjithësej u zhvilluan 16 intervista gjysmë të strukturuar respektivisht: më mësues (N=7), drejtues shkolle (N=4), mentor (N=3), një përfaqësues të ASCAP dhe një përfaqësues të ISHM.

Kampioni ka qenë i qëllimshëm duke qenë se në studim janë përfshirë mësues dhe nxënës që kanë qenë pjesë e projektit. Pyetësorët iu janë dërguar mësuesve dhe drejtuesve të shkollave, të cilët më pas i kanë ndarë tek nxënësit.

Nga 170 mësuesit e sistemit parauniversitar, të cilët i janë përgjigjur pyetësorit 57.1% japin mësim në shkollë të mesme të përgjithshme dhe 42.9% në shkollë 9-vjeçare.

Nga 973 nxënësit e sistemit parauniversitar, të cilët i janë përgjigjur pyetësorit 70% kanë qenë nga shkolla të mesme të përgjithshme dhe 30% nga shkollat 9-vjeçare.

3.5 Kufizimet e studimit

Niveli i sinqeritetit dhe besueshmërisë së përgjigjeve të dhëna nga nxënësit dhe mësuesit gjatë plotësimit të pyetësorëve online pavarësisht se mësuesit u udhëzuan për t'i informuar nxënësit mbi rëndësinë e të qenit objektiv dhe të vërtetë në plotësimin e pyetësorit.

Duke qenë se qershori ishte muaji i fundit i shkollës ishte pak e vështirë që mësuesit të gjenin kohë për zhvillimin e intervistave, kjo është dhe arsyeja që ata u lanë të lirë që të zgjidhnin përmes dy opsioneve përball dhe online.


IV. PREZANTIMI I GJETJEVE TË KËRKIMIT

Ky kapitull paraqet gjetjet e studimit sipas instrumenteve të përdorura dhe më pas një analizë të integruar të tyre.

4.1 Perceptimet e nxënësve


Pyetësit i janë përgjigjur 973 nxënës nga sistemi parauniversitar. Thuajse 70% nga shkolla të mesme të përgjithshme dhe 30% nga shkollat 9-vjeçare.

Figura 1: Niveli i shkollës – Nxënësit




Rreth 36% e nxënësve që i janë përgjigjur pyetësit ndjekin klasën e XI, rreth 20% ndjekin klasën e X dhe rreth 15% ndjekin klasën e XII sipas figurës më poshtë. 7.8% ndjekin klasën e IX; 8.2% klasën e VIII, 10.2% klasën e VII; 3.6% klasën e VI.

Figura 2: Klasa e nxënësve




Rreth 61% e të pyeturve janë vajza dhe 33% janë djem. Ndërkohë që 6% preferojnë mos t'i përgjigjen pyetjes së gjinisë.

Figura 3: Gjinia e nxënësve



58% e nxënësve që i janë përgjigjur pyetësorit janë në Tiranë, 18% në Durrës, 16% në Lezhë dhe 5% në Elbasan sipas figurës më poshtë.


Figura 4: Qyteti



Nxënësit kanë kuptime të larmishme të EMI-t, por me emërues të përbashkët sigurinë e informacionit dhe saktësinë e tij, si edhe lidhjen me mjetet digjitale.


Rreth 56% e nxënësve pohojnë se kishin informacion në nivel mesatar përpara aktiviteteve të zhvilluara në klasë lidhur me EMI-n. Ndërkohë që 19% kishin pak informacion dhe 20% kishin shumë informacion.

Figura 5: Informacioni për EMI para projektit




41% e nxënësve të pyetur konfirmojnë se kanë tashmë njohuri më të mira për sistemin mediatik pas realizimit të aktiviteteve të zhvilluara në klasë lidhur me EMI-n. Gjithashtu rreth 30% shprehen se kanë tashmë njohuri më të mira për informacionin në botën digjitale, sipas figurës më poshtë.

Figura 6: Njohuri të përfituara nga nxënësit pas realizimit të aktiviteteve




35% e nxënësve konfirmojnë se kanë përfituar aftësi të të menduarit kritik dhe rreth 29% pohojnë se kanë përfituar aftësi për zgjidhjen e problemeve, ndërsa rreth 20% që kanë fituar aftësi për të dalluar çrregullimet e informacionit.

Figura 7: Aftësitë EMI të përfituara nga nxënësit




52% e nxënësve që i janë përgjigjur pyetësorit konfirmojnë se EMI është shumë i rëndësishëm për ta. Rreth 41% konfirmojnë se EMI është i rëndësishëm.

Figura 8: Rëndësia e EMI-t




Rreth 38% e nxënësve konfirmojnë se EMI i ka ndihmuar në lëndë mësimore dhe rreth 46% në jetën e përditshme sipas figurës më poshtë.

Figura 9: Perceptimet e nxënësve përse u ka shërbyer EMI



40% e nxënësve mendojnë se duhet të trajnohen mësuesit që të përfshijnë EMI-n në programet mësimore në mënyrë që të rinjtë dhe bashkëmoshatarët e tjerë të aftësohen rreth EMI-t dhe rreth 19% mendojnë se duhet të trajnohen të rinjtë nga të rinjtë. 14% mendojnë se duhet të zhvillohen aplikacione dhe platforma online dhe 12% që të realizohen shkolla verore apo dimërore me fokus EMI-n.


Figura 10: Sugjerimet e nxënësve për EMI-n për të rinjtë e tjerë



4.2 Perceptimet e mësuesve


Pyetësit i janë përgjigjur në total 170 mësues të sistemit parauniversitar nga të cilët 57.1% japin mësim në shkollë të mesme të përgjithshme dhe 42.9% në shkollë 9-vjeçare.

Figura 11: Përkatësia e mësuesve sipas shkollës




Pjesa dërrmuese e mësuesve që i janë përgjigjur pyetësit janë gra, 87.6% dhe 10% burra, ndërkohë që 2.4% preferojnë mos të përgjigjen. Kjo pjesëmarrje shpjegohet me shpërndarjen gjinore në arsimin parauniversitar. Sikurse tregon dhe raporti i INSTAT 2021, në vitin akademik 2019-2020, në stafin mësimor mbizotërojnë gratë në ciklin e ulët dhe atë të mesëm, përkatësisht 75,5 % dhe 68,4 % e mësuesve të secilit nivel.

Figura 12: Përkatësia sipas gjinisë




Sa i takon vendndodhjes, shumica janë në Tiranë (62%), 11% në Lezhë dhe Durrës, të ndjekur nga Elbasani 9% dhe Kamza 7%. Kjo pjesëmarrje shpjegohet me faktin se 14 nga 20 shkollat e përfshira në projekt janë në Tiranë.

Figura 13: Qyteti




Në kampionin e pyetësorit përfaqësohen mësues të të gjitha lëndëve sipas figurës më poshtë.

Figura 14: Lënda




Të pyetur rreth nivelit të informacionit për EMI përpara fillimit të projektit, 60.6% e mësuesve konfirmojnë që kishin informacion në nivel mesatar dhe 28.8% që kishin pak informacion rreth EMI. Vetëm 4.7% e mësuesve konfirmojnë që kishin shumë informacion për EMI para fillimit të projektit dhe 5.9% nuk kishin fare informacion, sikurse tregohet dhe në figurën më poshtë.

Figura 15: Informacioni për EMI përpara projektit




Progresi pas marrjes pjesë në kursin e EMI-t në këtë projekt konfirmohet qartazi nga 74.7% e mësuesve të pyetur, të cilët konfirmojnë që tashmë kanë shumë informacion për EMI dhe rreth 23% konfirmojnë që kanë informacion mesatar.

Figura 16: Informacioni për EMI pas marrjes pjesë në kursin EMI




46.5% e mësuesve konfirmojnë që ndonjëherë kanë aplikuar element të EMI-t në mësimdhënie përpara projektit dhe po aq që kanë aplikuar shpesh.

Figura 17: Aplikimi i EMI në mësimdhënie përpara projektit




Ndërkohë që përdorimi i elementëve të EMI-t në procesin e mësimdhënies pas ndërhyrjes së projektit është shtuar. 26% e mësuesve konfirmojnë që e përdorin gjithmonë EMI-n në mësimdhënie dhe 66% e përdorin shpesh sipas figurës më poshtë.

Figura 18: Përdorimi i EMI-t në mësimdhënie pas pjesëmarrjes në projekt




Sa i takon ndihmesës së projektit në aftësitë e mësuesve për EMI, 78.8% konfirmojnë se i ka ndihmuar shumë për të përzgjedhur burimet e duhura nga fusha e gjerë e materialeve që vijnë nga burimet e medias dhe të informacionit; 70% pohojnë se i ka ndihmuar shumë për të përdorur median dhe informimin në kurrikulën shkollore; 65.3% pohojnë se i ka ndihmuar shumë për të vlerësuar në mënyrë kritike tekstet e medias dhe burimet e informacionit dhe 61.2% i ka ndihmuar shumë për të vlerësuar shkallën e të kuptuarit të EMI nga nxënësit.

Figura 19: Ndihmesa e projektit në aftësitë e mësuesve




68.8% e mësuesve konfirmojnë se kanë parashikuar objektiva mësimorë të lidhura me EMI-n përpara ndërhyrjes së projektit. Ndërkohë që thuhet 100% pohojnë se kanë planifikuar objektiva mësimorë që lidhen me përdorimin e medias pas ndërhyrjes së projektit sipas figurës më poshtë.

Figura 20: Objektiva mësimorë që lidhen me EMI-n para dhe pas projektit



Në pjesën dërrmuese (66.5%) të rasteve, mësuesit konfirmojnë se i kanë parashikuar këto objektiva që lidhen me median për përdorimin e medias për të siguruar informacion shtesë, përdorimin e medias për zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe përdorimin e medias për të shprehur në mënyrë krijuese qëndrimin e tyre.

Figura 21: Objektivat mësimorë të lidhur me median



Sa i takon sfidave për integrimin e EMI-t në kurrikulën e arsimit parauniversitar, rreth 30% e mësuesve konfirmojnë se planifikimi i veprimtarive të veçanta që synojnë të vëzhgojnë arritjet e nxënësit në procesin e të nxënës ka qenë sfida kryesore dhe rreth 22% pohojnë se sfida tjetër kryesore ka qenë planifikimi i veprimtarive konkrete për përfshirjen e nxënësve në detyra që lidhen me EMI. Ndërkohë që 14% shprehen që nuk kanë hasur ndonjë vështirësi të veçantë.

Figura 22: Sfidat për integrimin e EMI-t në kurrikulën e arsimit parauniversitar



Ndërkohë sfida kryesore që mësuesit hasin në procesin e mësimdhënies me nxënësit kur aplikojnë elementët e EMI-t në shkollë është mungesa e aksesit në Internet ose në teknologji (63.5%). 12.4% e mësuesve pohojnë se edhe diskutimi i temave me ndjeshmëri të lartë është sfidues dhe 11.2% pohojnë se hasin vështirësi në përshtatjen e informacionit sipas moshave.

Figura 23: Sfidat në procesin mësimor me fëmijet lidhur me EMI-n




Sa i takon mentorimit, 97.1% e mësuesve e vlerësojnë që ka qenë ndihmues për të kuptuar më shumë integrimin e EMI-t në orën e mësimit sipas figurës më poshtë.

Figura 24: Vlerësimi i mentorimit sipas mësuesve




Më shumë se gjysma e mësuesve (52.4%) mendojnë se nxënësit kanë përfituar aftësi të të menduarit kritik si rezultat i projektit dhe 34.1% mendojnë që kanë përfituar njohuri më të mira për EMI-n në tërësi dhe rreth 13% pohojnë se kanë përfituar aftësi për zgjidhjen e problemeve.

Figura 25: Përfitimet e nxënësve sipas mësuesve




Mësuesit pohojnë se realizojnë qëllime të ndryshme përmes përdorimit të elementëve të EMI-t të integruar në mësimdhënie sikurse vlerësimi kritik i medias (50%), mbrojtja nga ndikimi negativ i medias (44.7%), largimi i nxënësve nga zakonet e këqija të konsumit të medias (27.6%) sipas figurës më poshtë.

Figura 26: Qëllimi i përdorimit të EMI-t për nxënësit sipas mësuesve




Thuajse të gjithë mësuesit që iu përgjigjën pyetësorit, konfirmojnë që EMI është i rëndësishëm: 44.1% mendojnë se është shumë i rëndësishëm dhe 53.5% që është i rëndësishëm.

Figura 27: Rëndësia e EMI-t sipas mësuesve



50.6% e mësuesve konfirmojnë që trajnimet e EMI-t duhet të ofrohen për të gjithë mësuesit dhe 31.2% mendojnë se mësuesit duhet të përfshihen në trajnime të vazhdueshme për rritjen e kompetencave në këtë fushë.

Figura 28: Mendimi i mësuesve për zhvillimin profesional lidhur me EMI-n



V. DISKUTIME: ANALIZA E TË DHËNAVE CILËSORE

Bazuar në të dhënat cilësore, në këtë kapitull paraqitet një analizë lidhur me rëndësinë e EMI-t në shkollë, trajnimi, mentorimi dhe sfidat e projektit.

5.1 Rëndësia e EMI në shkollë

Të gjithë profesionistët e intervistuar raportojnë që EMI është shumë i rëndësishëm për shkollën, nxënësit dhe mësuesit. Edhe pse nxënësit njihen në lëndë të veçanta me elementë të ndryshëm në lidhje me median dhe informacionin, projekti krijoi një të kuptuar shumë më të qartë dhe gjithëpërfshirëse duke ndihmuar mësuesit dhe nxënësit që të zhvillojnë forma të reja të kompetencave (njohuri, aftësi dhe qëndrime), të zotërojnë aftësitë bazë për të menduar kritik, për t'u shprehur dhe për të marr pjesë në mënyrë aktive në procesin shkollor.

Mësuesit raportojnë që kanë përdorur elementë të ndryshëm të medias dhe informacionit, por jo në mënyrë të strukturuar dhe të planifikuar siç ka ndodhur pasi janë trajnuar dhe janë mbështetur nga mentorët. Informacionet e shumta me të cilët përballen mësuesit dhe nxënësit krijojnë konfuzitet dhe shumë dilema për vërtetësinë dhe përzgjedhjen e informacionit të duhur. Rritja e kapaciteteve të mësuesve dhe të kuptuarit për EMI ka ndihmuar që ata vetë të kërkojnë për burime të sigurt të informacionit dhe të orientojnë dhe nxënësit në përzgjedhjen e informacioneve të duhura. Të gjithë raportojnë që EMI është i nevojshëm për t'i informuar dhe për t'i fuqizuar mësuesit dhe nxënësit me aftësitë e duhura për të analizuar në mënyrë kritike informacionin dhe për të dalluar midis të vërtetës dhe gënjeshtërs.

“EMI ndihmon në nxitjen e të menduarit kritik tek nxënësit, e kutivimit të lirisë së të shprehurit dhe përdorimin e informacionit nga burime të sigurt, të cituara dhe të vlefshme për çfarëdolloj ore mësimore”

Mësuese, Tiranë

Mësuesit theksojnë se EMI do të ndihmojë nxënësit që të mos jenë shumë sipërfaqësorë në përdorimin e internetit dhe gjithmonë e më shumë ta përdorin edhe si burim për edukim dhe informim të vazhduar në mënyrë produktive, njëkohësisht duke zvogëluar

rrisqet që sjell përdorimi i internetit. Ata raportojnë që është shumë e rëndësishme që të kultivojnë tek nxënësit përdorimin e dobishëm të medias për të ndërtuar një të nxënë të shëndetshëm dhe kritik. Ndërgjegjësimi dhe zhvillimi i aftësive të nxënësve se si të ndërveprojnë me forma të ndryshme të medias është thelbësore, sepse në të ardhmen ata jo vetëm do të përcjellin lajmet dhe informacionin që hasin në përditshmëri, por shpesh do të jenë përgjegjës edhe për prodhimin e informacioneve.

Projektet që sjellin ide inovatore dhe një frymë të re konsiderohen shumë të rëndësishme nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollave pasi sjellin një të menduar ndryshe nga ajo çfarë mësuesit janë mësuar zakonisht që të përdorin në orë mësimore.

Disa nga të intervistuarit raportojnë që projekti u ka dhënë mundësinë që të dalin disi nga mësimdhënia tradicionale dhe të fokusohen më shumë në burimet e ndryshme të informacionit dhe integritit të tyre në orët e mësimit. Zhvillimi profesional i mësuesve në fushën e EMI ka bërë që ata të fillojnë të kenë një të menduar ndryshe për mënyrën sesi mund t'i përfshijnë burimet e ndryshme të informacionit në orën e mësimit. Në fillim është perceptuar sfiduese, por trajnimi dhe mentorimi i ofruar nga projekti ka ndihmuar që ata të zhvillojnë aftësitë e duhur, të rrisin të kuptuarit dhe zhvillojnë kompetencat që përfshijnë aftësinë për të aksesuar, kërkuar, analizuar dhe vlerësuar përmbajtjen dhe informacionin e medias, si dhe përdorimin e mediave dhe teknologjive për të ndarë informacionin dhe për të zhvilluar orët e mësimit.

5.2 Trajnimi i mësuesve

Në projekt janë përfshirë 20 shkolla 9-vjecare dhe të mesme, nga qytetet e Tiranës, Durrësit, Elbasanit dhe Lezhës. Trajnimi është ofruar për 240 mësues: Të gjithë pjesëmarrësit vlerësuan të domosdoshme zhvillimin e trajnimit në fushën e EMI-t, që krijoi një bazë të mirë të të kuptuarit të përbashkët dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për integrimin e EMI në kurrikulën e arsimit parauniversitar. Të gjithë mësuesit dhe drejtuesit e intervistuar u shprehën se pas trajnimit ata kishin një të kuptuar dhe qasje tjetër të EMI në orën e mësimit, duke theksuar: kërkesat që kishin për nxënësin, mënyrën sesi e përfshinin EMI në orën e mësimit, analizën e informacionit që ata vet duhet të bënin përpara një ore mësimi, udhëzimet që jepnin për nxënësit në përgatitjen e detyrave, mënyrat sesi informacioni reflektohej dhe shprehej nga nxënësit, faktet shumë interesante që sillnin nxënësit me punimet e tyre, nxitja e nxënësve që të lexojnë përtej sipërfaqes së mesazheve mediatike që hasin në përditshmëri, ndihma për nxënësit të kërkojnë mënyra alternative për t'u informuar.

“Fillimisht ne nuk ishim të mirëinformuar për të gjitha, kishim nevojë për informacione dhe orientime.”

Mësuese, Durrës

“Trajnimi ishte shumë i nevojshëm. Ne e kishim përdorur EMI-n sipas mënyrës tonë. Ka informacione përtej librave.”

Mësuese, Tiranë

Është e rëndësishme të kuptohet se, edhe pse mësuesit kanë akses të lirë në shumë burime mësimore, në shumë raste atyre u mungojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'i përdorur këto burime në mënyrën e duhur dhe kjo është arsyeja pse këto sesione trajnimi janë kaq të rëndësishme.

Pas trajnimit mësuesit shprehën se kanë përdorur shumë më tepër burime të informacionit sipas lëndëve përkatëse duke strukturuar ndryshe orën e mësimit, duke përdorur metoda që kanë rritur pjesëmarrjen e nxënësve. Mësuesit kanë qenë shumë më të kujdesshëm në dhënien e udhëzimeve për informacionet që kanë kërkuar nga nxënësit dhe kjo ka bërë që nxënësit të orientohen që të marrin më të mirën nga ajo që ofron media pasi është shumë e gjerë. Orientimi është konsideruar shumë i rëndësishëm edhe sepse lundrimet në internet janë të rrezikshme dhe nevoja për t'i informuar nxënësit është shumë e madhe.

“Nxënësve u pëlqen që të ndërlihin pjesën e teknologjisë me mësimin sepse ju duket argëtuese dhe jo monotone. Nxënësit janë përfshirë në aktivitete konkrete dhe duke e parë reagojnë, nxiten që të shprehin mendimin e tyre”.

Mësuese, Durrës

“Në momentin që bëme trajnimin e EMI-t, kuptuam që duhet të ishim të strukturuar në gjërat që kërkonim nga nxënësit. Duhej të kishim një lloj organizimi ndryshe, të niseshim drejtë vërtetësisë, informacionit të sigurtë dhe të vërtetë, të kishim interes ndaj informacionit përtej librit dhe përtej shkollës, pavarësi në marrjen e informacionit, të orientohej nxënësi drejtë dhe saktë.”

Mësuese, Tiranë

Gjatë trajnimit vlerësohet edhe pjesa e bashkëpunimit që pjesëmarrësit e shkollave të ndryshme kanë pasur me njëri-tjetrin, si dhe pjesa e eksperiencave, sfidave dhe shembujve që ata kanë sjellë nga praktika.

Pavarësisht nga lëndët që jepnin, të gjithë mësuesit pranuan që mbledhja dhe verifikimi i të dhënave dhe informacionit, komunikimi dhe riprodhimi i njohurive janë të gjitha aspektet që ndodhin në të gjitha fushat lëndore. Sigurisht që pajisja e mësuesve me aftësi dhe njohuri në mënyrë që ata të mund të mbështesin nxënësit e tyre i ka bërë ata më konfident pasi ata shpreheshin që fëmijët janë përdorues më të mirë të teknologjisë.

Ka një interes të vërtetë nga shumë mësues për të avancuar njohuritë e tyre në shumë aspekte që lidhen me EMI dhe ata vërtet e vlerësuan shumë trajnimin madje theksuan që ka nevojë që të pasohet edhe me trajnime të tjera më të thelluara.

Trajnimi mbi përdorimin e medias si burim informacioni përmes teknikave të përshtatshme hapi një fushë të re të punës së ASCAP me mësuesit në këtë fushë. Mungojnë kriteret e unifikuara të vlerësimit të performancës së mësuesit mbi EMI-n dhe u pilotua ideja e një performance në tre nivele të mësuesit: EMI si mjet për informacion; si metodë për nxitjen e mendimit kritik; dhe si metodë për krijimin e përmbajtjes ose për t'u shprehur.

5.3 Përfshirja e EMI në orën e mësimit dhe puna me nxënësit

Rritja e kapaciteteve të mësuesve ka ndihmuar që të kuptojnë dimensionin shumë më të gjerë të EMI-t dhe të pranojnë vendin që ai zë në të gjitha lëndët, si dhe ta shikojnë të integruar në orën e mësimit dhe jo si një çështje që duhet trajtuar më vete. Mësuesit përgjithësisht janë gjithmonë e më të hapur për risitë, duke qenë se tashmë ata e shikojnë EMI si një domosdoshmëri në punën e tyre me nxënësit. Projekti u mundësoi një bazë të fortë dhe të rëndësishme mbështetjeje për ta kuptuar EMI-n, për të rritur kapacitetet, për të ndarë ekspereinca, për të marr mbështetje të ndryshme me mentor, botime, bazë materiale, etj. Kjo rriti vetëbesimin dhe ndihmoi që ta shikojnë si një element parësor ndihmues në procesin mësimor dhe të zvogëlojnë atë kërcënimin që ndjenin herë pas herë në orën e mësimit, si rezultat i aftësive më të mira të nxënësve në teknologji, internet.

“Duket pak e vështirë që shkenca të ndërthuret me median, por ka shumë mënyra informimi. Në mësimdhënie është ndihmës dhe në lëndën e fizikës gjen ndërthurje. Në media ka shumë mënyra informimi, nxënësit kanë përdorur video edhe në anglisht, stimulime. Një pjesë e nxënësve i kanë ngarkuar eksperimentet në YouTube. Kjo i nxit që të jenë në qendër të vëmendjes që edhe në shkollë është e vështirë të sigurohet”.

Mësuese, Durrës

Edukimi për EMI rrit mundësinë e ndërtimit të njohurive përmes ofrimit të një perspektive unike për kuptimin e mesazheve mediatike. Ai ofron mundësi për të konsoliduar dhe zgjeruar zhvillimin e kompetencave dhe njohurive të fituara në fusha të tjera të kurrikulës, si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit. Siç edhe raportohet mësuesit e kanë përdorur gjerësisht EMI për të identifikuar burimet e informacionit, për të vlerësuar besueshmërinë, saktësinë e burimeve dhe më pak kanë kaluar edhe në dimensionin e EMI si metodë për nxitjen e mendimit kritik. Kjo reflektohet edhe nga shembujt që ato ndanë për mënyrat e organizimit të orëve të mësimit.

“Jeta e Balzakut, nuk dinim mënyrën e jetesës së tij dhe një nxënëse solli fakte që nuk i dinim dhe ishin shumë interesante. Ne bëmë lidhjen midis jetës së tij, tematikave të veprave të tij. Nëse zbatohet EMI ne do gjejmë gjëra shumë interesante ku dhe nxënësi do të bëhet kurioz”.

Mësuese, Tiranë

“Drejtëshkrimi i gjuhës shqipe, si ndikon media, gabimet që përdorin media, mënyra se si shkruajnë, përdorimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe. Nxënësit kanë marrë emisione të ndryshme dhe kanë parë gazetarët, të cilët përdorin fjalë të huaja ose kanë lexuar shkrimet në mediat televizive, të cilat shkruajnë me gabime drejtëshkrimore. Ka qenë temë projekti për klasën e shtatë dhe e kishin realizuar shumë mirë projektin”.

Drejtuese shkolle, Tiranë

“Na duhet të punojmë pak më shumë me mendimin kritik dhe krijimin e përbajtjes. Niveli i dytë dhe i tretë janë të vështira. Nxënësit nuk dinë të krijojnë, e kanë më të thjeshtë të kopjojnë.

Mësuese, Durrës

Shumë nga mësuesit bien dakord se një nga qëllimet kryesore të arsimit është të ndihmojë të rinjtë të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik. Ata vlerësojnë si shumë të rëndësishme praktikat e EMI-t të cilat janë të lidhura ngushtë me praktikat e rekomanduara për zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik në atë që u ofrojnë nxënësve një filtër më aktiv dhe më të qartë për të përpunuar imazhe, mesazhe mediatike dhe çdo burimi informacioni që marrin nga media.

Në punën me nxënësit raportohet që nxënësit treguan një përmirësim në rritje të cilësisë së projekteve që ata kishin si detyrim që të dorëzonin në lëndë të ndryshme. Nxënësit filluan që të ishin më kritikë në përzgjedhjen e burimeve të informacionit dhe kjo vinte edhe si rezultat i udhëzimeve që mësuesit jepnin.

“Përdorimi i informacionit cilësor, ky është qëllimi dhe përçimi te shokët e vet. Përmirësimi është shumë i rëndësishëm, sepse dorëzimi i një projekti nga një herë ishte një printim i një faqeje copy-paste gjë që dhe ai që e kishte dorëzuar ndoshta nuk e kishte lexuar fare se çfarë kishte zgjedhur atje. Ndërsa në qoftë se nxënësi udhëzohet se çfarë informacioni të gjejë, sesi ta gjejë, ndahen detyrat në grupe, ftohet që ta interpretojë, të japë mendimin e tij, etj atëherë ai do të zhvillojë një punë shumë më të plotë dhe do marrë shumë më tepër kënaqësi nga gjithë procesi”.

Drejtues shkolle, Tiranë.

EMI ka lehtësuar procesin e të mësuarit pasi nxënësit kanë siguruar lloje të ndryshme informacioni që kanë ndihmuar të kuptuarit e të gjitha niveleve të nxënësve në klasë.

5.4 Mentorimi

Mentorimi vlerësohet nga të gjithë mësuesit dhe drejtuesit e shkollave si shumë pozitiv dhe ka rritur angazhimin e mësuesve dhe nxënësve për të realizuar orë mësimi me sa më shumë elementë të EMI-t. Për nxënësit ka qenë me interes pasi ata e kanë vlerësuar që dikush është interesuar për punën e tyre dhe kanë qenë të kënaqur që kanë bërë një orë ndryshe.

“Pa mentorim nuk do të ishim të aftë të kuptonim EMI-n, të bënim një orë interaktive dhe të pasur”.

Mësuese, Durrës

Mentorimi e bëri më të lehtë lidhjen e teorisë me praktikën. Shkëmbimi i mendimeve me mentorin, diskutimi mbi elementë të caktuar të orës së mësimi, dhënia e sygjërimeve dhe feedback-u i marr mbi orën e mësimi ka orientuar mësuesit sesi të kërkojnë, vlerësojnë, të përdorin dhe të krijojnë informacion gjatë mësimdhënies.

Mësuesit sygjerojnë që mentorimi duhej të bëhej disa herë dhe jo vetëm një herë, duke qenë se një orë mësimi është pak a shumë demonstrative, ndërkohë që në vazhdim mësuesi mund të tregojë edhe nivele të tjera të përgatitjes gjatë orëve të mësimi dhe krijon mundësinë që të thellohet dhe të avancojë më shumë në përdorimin e EMI.

Mentorët konfirmojnë gjithashtu nevojën për mentorim të vazhdueshëm dhe të përshtatur me nevojat specifike të mësuesve dhe lëndëve të tyre.

“Mentorimi gjatë gjithë kohës është shumë i rëndësishëm për mësuesit, por ai duhet të jetë i vazhdueshëm dhe t’u përgjigjet kërkesave të tyre”.

Mentor

Mentorët theksojnë se integrimi i EMI-t duhet të jetë edhe pjesë e zhvillimit profesional të mësuesve dhe të përforcohen rrjetet e mësuesve që punojnë me EMI. Mëgjithatë ata theksojnë edhe sfidat që ka ky proces, sidomos sa i takon infrastrukturës digjitale në dispozicion.

“Zgjerimi i EMI-t në të gjitha shkollat dhe universalizimi i kësaj qasje kërkon edhe akses në pajisje teknologjike dhe internet të garantuar në shkolla dhe kjo jo gjithmonë është e mundur të paktën jo deri tani, por është e nevojshme”.

Mentor

5.5 Sfidat në integrimin e EMI-t në kurrikulat mësimore

Sfidë është implementimi, EMI duhet të vijë në një mënyrë të strukturuar dhe të organizuar në orën e mësimin, sidomos në fillimet e punës me këtë fushë të re që edhe mësuesit nuk kanë kapacitetet dhe aftësitë e nevojshme për të qenë spontan dhe krijues. EMI duhet të jetë pjesë e integruar e kurrikulës, dhe të ketë një plan ndërhyrje për çdo lëndë. Shumë i rëndësishëm është planifikimi i orëve në planin mësimor që në fillim të vitit, sepse integrimi i tyre kërkonte pak sforcë nga ana e mësuesve ndërkohë që procesi mësimor kishte filluar. Draft kurrikula e EMI-t për mësuesit e ciklit parauniversitar dhe mentorimi kanë qenë mjaft ndihmues për mësuesit që të kenë një të kuptuar të përbashkët dhe të aftësohen në përdorimin e saj.

“Duke iu përkushtuar librit, metodave të mësimdhënies, EMI-n e kishim spostuar dhe e kishim lënë mënjanë ose ju kishim thënë merrni informacion, por nuk i kishim orientuar drejtë. EMI duhet të jetë e organizuar dhe jo çfarë të më teket mua apo nxënësit”.

Mësuese, Tiranë

Sfidë është pjesa e kushteve të çdo shkollë, infrastruktura e shkollës, kompjuterat, kapacitetet e mësuesve. Të gjithë të intervistuarit raportuan mungesën e infrastrukturës si një shqetësim kryesor. Mungesa e teknologjisë në shkollë, por edhe në shtëpi për shumë nga fëmijët e bën të vështirë zbatimin në praktikë të EMI në momente të caktuara.

Projekti ka ndihmuar dy shkolla me blerjen e disa pajisjeve bazë si: kompjuter, projektor, laptop, mjetet e nevojshme të cilat do t'i ndihmonin për të bërë një laborator të medias. Kjo ka qenë shumë pozitive pasi mësuesit kanë përdorur mjetet për të demonstruar dhe zhvilluar orë të ndryshme mësimore me nxënësit dhe për të rritur ndërveprimin e tyre përmes teknologjisë.

Rritja dhe zhvillimi i aftësive të mësuesve për ta vënë në zbatim EMI kërkon një trajnim të vazhduar dhe një përfshirje të të gjithë mësuesve. Mungesa e burimeve financiare bën që shtrirja dhe mbulimi i nevojave të jetë vetëm në nivel projekti dhe të mos kemi një shtrirje kombëtare në të gjitha shkollat.

VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në këtë kapitull prezantohet mësimet e nxjerra, disa modele të mira dhe rekomandimet bazuar në ndërthurjen e gjetjeve sasiore dhe cilësore.

6.1 Mësimet e nxjerra

Koha në dispozicion të projektit nuk ka qenë e mjaftueshme, ndërhyrja në shkolla duhet të shtrihej në një kohë më të gjatë dhe të shoqërohej me trajnime, mentorime, mbështetje me burime të ndryshme materiale në mënyrë intensive. Duke qenë se një pjesë e projektit është zbatuar edhe gjatë kohës së pandemisë kjo e ka rritur edhe më shumë vështirësinë në zbatim.

Trajnimet e mësuesve duhet të jenë të konsoliduara ku të përfshihen më shumë profesionistë për përgatitjen e përmbajtjes dhe ofrimin e tyre. Trajnimet të ofrohen në ditë të shkëputura me qëllim që mësuesit të mos pengohen në procesin e mësimdhënies, të marrin kohën e mjaftueshme për leximin e materialeve dhe të krijohet mundësia që edhe gjatë trajnimit mësuesit të përfshihen në realizimin e detyrave praktike, reflektuese, prezantuese për të rritur si kompetencat teorike dhe praktike në lidhje me EMI.

6.2 Praktika të mira

Mësuesit falë përdorimit të EMI-t kanë nxitur gjithëpërfshirjen e nxënësve, pasi të gjithë nxënësit donin të përfshiheshin dhe të jepnin mendimin dhe të gjithë e gjenin veten brenda një ore mësimi. Ka qenë nxitëse për fëmijët për të eksploruar dhe për të sjell informacione të veçanta dhe specifike në lidhje me temën e mësimit dhe jo thjeshtë gjetja e informacioneve më të lehta për ata.

Drejtuesit e shkollave dhe mësuesit e përfshirë në projekt kanë zhvilluar një kuptim në rritje të rëndësisë që ka zhvillimi i aftësive dhe kompetencave në fushën e EMI-t. Ky ndërgjegjësim për rëndësinë që ka mësimi i aftësive bazë të EMI për nxënësit mund të kontribuojë në zbatimin me përpikmëri të kurrikulave duke sjell edhe një lloj lehtësie dhe sigurie për mësuesit në arritjen e rezultateve të të nxënësve në fushat përkatëse të edukimit. Të gjithë mësuesit raportojnë që kanë nxitur nxënësit që të vinin

në pikëpyetje burimin dhe saktësinë e informacionit dhe kanë theksuar vazhdimisht problematikat që lidhen me keqinformimet, ruajtjen e të dhënave personale, rreziqet gjatë përdorimit të internetit.

Nxënësit janë ndjerë shumë mirë në orët e mësimit dhe kanë qenë shumë krijues në tema të ndryshme dhe në përgatitjen e posterave, videove, prezantimeve duke e shprehur përmbajtjen në forma të ndryshme.

“Fëmijët kishin mbledhur informacione që ne mbetëm të habitur.”

Mësuese, Tiranë

Trajnimi i një grupi mësuesish për çdo shkollë është shumë pozitiv pasi ka krijuar disa kapacitete për shkollën që mund të ndihmojnë dhe informojnë edhe kolegët e tjerë. Nga ana tjetër mësuesit e trajnuar kanë qenë mbështetje për njëri-tjetrin dhe kanë ndarë eksperiencat dhe kanë kërkuar ndihmë përgjatë vitit shkollor. Trajnimi i mësuesve në fushën e EMI është i rëndësishëm për prodhimin e zbatimit me cilësi të lartë të kurrikulave arsimore.

Një praktikë e mirë është dizenjimi i fletës së ditarit për pilotimin e EMI-t në orën mësimore që ASCAP ka realizuar së bashku me mësuesit. Nëpërmjet kësaj flete ditari mësuesit kanë dhënë idetë sesi mund ta përdornin EMI-n në një orë mësimi dhe janë mbështetur nga mentorët për integrimin e EMI-t në orë të caktuara sipas planit mësimor.

Materialet e ndryshme burimore (botime, video, etj.) të EMI që janë ofruar për mësuesit në shqip kanë qenë ndihmuese që mësuesit të kenë mundësinë të lexojnë dhe informohen më gjerësisht, si dhe të referojnë tek këto burime edhe kolegë të tjerë.

6.3 Rekomandime

Mësuesit duhet të rrisin kompetencat arsimore të nevojshme për të promovuar edukimin mediatik mes nxënësve të tyre. EMI të bëhet pjesë e një programi të detyrueshëm trajnimi për të gjithë mësuesit, që ta shohin EMI si një mundësi për përgatitjen e nxënësve për rolet e tyre si qytetarë dhe konsumatorë dhe për pjesëmarrje efektive në diskursin demokratik.

Përdorimi i teknologjisë në orën e mësimit është një nxitës që nxënësit të përfshihen dhe aktivizohen më shumë sesa në rastet kur përdoren format tradicionale të edukimit përmes librit, shkumësit dhe shpjegimit në tabelë të mësuesve.

Vazhdimësia e projektit dhe mbështetja e shkollave për të zhvilluar edhe dimensionet e tjera të EMI si mendimi kritik dhe krijimin e përmbajtjes dhe të shprehurit kërkon

një investim më afatgjatë. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional do të jetë thelbësor për të adresuar ndryshimet dhe zhvillimet në këtë fushë dhe për t'iu përgjigjur me strategjitë e duhura pedagogjike.

Të krijohen module mbi ligje, etikën dhe të drejtën e autorit, me qëllim që mësuesit dhe nxënësit të njohin dhe të edukohen mbi përdorimin e informacionit nga burime të ndryshme.

Zhvillimi i planeve të trajnimit në nivel shkolle ku mësuesit e trajnuar të trajnojnë edhe mësuesit e tjerë në shkolla për të patur një mbulim më të gjerë të trajnimit të të gjithë mësuesve.

Zhvillimi i një infrasktruktura bazë në shkolla, laboratore të medias (që do të përfshinte kompjutera, projektor, internet, pajisje për regjistrime audio dhe video, biblioteka, etj) me qëllim që nxënësit jo vetëm të marrin informacione, por edhe të zhvillojnë më tej aftësitë dhe kompetencat në fushën e EMI.

Të krijohet rrjeti profesional i mësuesve për EMI në mënyrë që mësuesit që kanë punuar në EMI-n të mund të vazhdojnë të bashkëpunojnë dhe mësuesit e rinj të gjejnë mbështetje për punën e tyre.

REFERENCA

- UNESCO, 'Global Media and Information Literacy Assessment Framework: Country Readiness and Competencies' (Paris: UNESCO, 2013a).
- UNESCO (2013b). Conceptual relationship of Information Literacy and Media Literacy in Knowledge Societies. Series of Research Papers, WSIS+10 Review. Paris: UNESCO. http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CI/CI/pdf/wsis/WSIS_10_Event/WSIS_-_Series_of_research_papers_-_Conceptual_Relationship_between_Information_Literacy_and_Media_Literacy.pdf
- Unesco (Ed.) (2013c). Media and information literacy: Policy and strategy guidelines. United Nations Educational. <https://bit.ly/2SOpEKb>
- Unesco (Ed.) (2019). Marco de competencias de los docentes en materia de TIC. Versión 3.0. Unesco. <https://bit.ly/396mlq0>
- Wilson, C., Grizzle, A., Tuazon, R., Akyempong, K., & Cheung, C.K. (2011). Alfabetización mediática e informacional: Curriculum para para profesores. Unesco. <https://bit.ly/2UKHJcG>
- Wilson, C. (2012). Media and Information Literacy: Pedagogy and Possibilities. Dossier. DOI: 10.3916/C39-2012-02-01
- Drafti i Udhëzimeve të UNESCO-s për Standardet Globale për Edukimin mbi Median dhe Informacionin (UNESCO Draft Global Standards for Media and Information Literacy Curricula Guidelines), https://www.unesco.org/sites/default/files/medias/files/2022/02/Global%20Standards%20for%20Media%20and%20Information%20Literacy%20Curricula%20Development%20Guidelines_EN.pdf
- Kellner, D. 1995. Media Culture. New York: Routledge
- Mihailidis, Paul. 2009. Media Literacy: Empowering Youth Worldwide. Washington: Center for International Media Assistance
- Moeller, Susan D. 2009. Media Literacy: Understanding the News. Washington: Center for International Media Assistance.
- Masterman, Len. 2003. Teaching the Media. New York: Routledge
- Mahoney, M. H. (2017). An academic librarian's search for meaning: A survey of lifelong learning in library literature. Journal of Academic Librarianship, 43(6), 540–547. <https://doi.org/10.1016/j.acalib.2017.05.004>
- Organización de Naciones Unidas (ONU) (Ed.) (2015). Objetivos de desarrollo del milenio. Informe de 2015. Naciones Unidas. <https://bit.ly/39bVitA>
- European Parliament and the Council: Recommendation of the European Parliament and the Council of 18 December 2006 on key competences for lifelong learning. In: Official Journal of the European Union, L394 (2006).
- Persson, M.: A vision of European teaching and learning: perspectives on the new role of the teacher. The Learning Teacher Network, Karlstad (2006)
- Ala-Mutka, K., Redecker, C., Punie, Y., Ferrari, A., Cachia, R., & Centeno, C.: The future of learning: European teachers' visions. In: Report on a foresight consultation at the 2010 eTwinning Conference. Seville. (2010, February)
- McGill, L.: Transforming curriculum delivery through technology": JISC Programme Synthesis Report (2011).
- INSTAT, 2021, "Burra dhe Gra 2021", <http://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf>

SHTOJCA

Pyetësor për Nxënësit

Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) me mbështetjen e UNESCO dhe Bashkimit Evropian është duke zhvilluar një raport kërkimor që ka si qëllim mbledhjen e evidencave dhe identifikimin e rezultateve të arritura mbi Edukimin për Median dhe Informacionin (EMI) në 20 shkollat pilot ku është zbatuar projekti “Krijimi i besimit në media në Evropën Juglindore dhe Turqi, faza e II-të”. Qëllimi i sondazhit është që të vlerësojë sesi ka ndihmuar projekti në rritjen e aftësive të të rinjve për edukimin mbi median dhe informimin (EMI) përmes integritit të kurrikulës së EMI-t të në sistemin edukativ formal në Shqipëri.

Ne garantojmë që i gjithë informacioni që ju do të na jepni gjatë plotësimit të këtij pyetësori do të jetë konfidencial, duke garantuar privatësinë tuaj.

Ju falenderojmë për pjesëmarrjen!

Shkolla: a. 9-vjeçare b. E mesme
 Emri i Shkollës _____
 Qyteti _____
 Klasa: _____
 Gjinia: a. M b. F

1. Si e kuptoni ju EMI – Edukimi për Median dhe Informacionin?

2. Sa njohuri kishit ju për median dhe informacionin përpara aktiviteteve të zhvilluara në klasë lidhur me këtë:
 - a. Kisha shumë informacion
 - b. Kisha informacion në një nivel mesatar
 - c. Kisha pak informacion
 - d. Nuk kisha fare informacion

3. Sa njohuri mendoni se keni përfituar për median dhe informacionin pas realizimit të aktiviteteve të zhvilluara në klasë lidhur me këtë:
 - a. Kam tashmë njohuri më të mira për sistemin mediatik
 - b. Kam tashmë njohuri më të mira për informacionin në botën digjitale
 - c. Kam tashmë njohuri më të mira për mënyrën si funksionojnë rrjetet sociale
 - d. Kam tashmë njohuri më të mira për çrregullimin e informacionit: propaganda, keqinformimi, manipulimi, gjuha e urrejtjes etj.

4. Cilat kanë qenë përfitimet kryesore tuajat sa i takon aftësive:
- e. Kam fituar aftësi për zgjidhjen e problemeve
 - f. Kam fituar aftësi të menduarit kritik
 - g. Kam fituar aftësi për të dalluar çrregullimin e informacionit
 - h. Kam fituar aftësi për të prodhuar përmbajtje mediatike
 - i. Tjetër _____
5. Sa i rëndësishëm është për ju Edukimi për Median dhe Informacionin:
- a. Shumë i rëndësishëm
 - b. I rëndësishëm
 - c. Jo shumë i rëndësishëm
 - d. I pa rëndësishëm
6. Edukimi për Median dhe Informacionin më ka ndihmuar në:
- a. lëndët mësimore
 - b. aktivitetet jashtë shkollore
 - c. jetën e përditshme
 - d. tjetër
7. Si mendoni se duhet të realizohet për të rinjtë dhe bashkëmoshatarët e tjerë Edukimi për Median dhe Informacionin?
- a. Të trajohen mësuesit që ta përfshijnë EMI në programet mësimore
 - b. Të trajohen të rinjtë nga të rinjtë
 - c. Të realizohen shkolla verore apo dimërore me fokus EMI
 - d. Të zhvillohen aplikacione dhe platforma online
 - e. Të zhvillohen fushata ndërgjegjësuese
 - f. Tjetër _____

8. Cilat aspekte të EMI ju pëlqeu më shumë?

9. Cilat do ishin sugjerimet tuaja?

Pyetësor për mësuesit

Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) me mbështetjen e UNESCO dhe Bashkimit Evropian është duke zhvilluar një raport kërkimor që ka si qëllim mbledhjen e evidencave dhe identifikimin e rezultateve të arritura mbi edukimin për median dhe informimin në 20 shkollat pilotë ku është zbatuar projekti “Krijimi i besimit në media në Evropën Juglindore dhe Turqi, faza e II-të”. Qëllimi i sondazhit është që të vlerësojë sesi ka ndihmuar projekti në rritjen e aftësive të rinjve për edukimin mbi median dhe informimin (EMI) përmes integritit të kurrikulës së EMI-t të në sistemin edukativ formal në Shqipëri.

Ne garantojmë që i gjithë informacioni që ju do të na jepni gjatë plotësimit të këtij pyetësori do të jetë konfidencial, duke garantuar privatësinë tuaj.

Ju falenderojmë për pjesëmarrjen!

Shkolla: a. 9-vjecare b. E mesme
 Emri i Shkollës _____
 Qyteti _____
 Lënda _____
 Gjinia: a. M b. F

1. Cfarë do të thotë për ju EMI (Edukimi për Median dhe Informacionin)

2. Cili ishte niveli juaj i informacionit për EMI përpara fillimit të projektit:
 - e. Kisha shumë informacion
 - f. Kisha informacion në një nivel mesatar
 - g. Kisha pak informacion
 - h. Nuk kisha fare informacion
3. Cili është niveli juaj i informacionit për EMI pas kursit të EMI:
 - a. Kisha shumë informacion
 - b. Kisha informacion në një nivel mesatar
 - c. Kisha pak informacion
 - d. Nuk kisha fare informacion
4. Sipas jush sa mendoni se keni aplikuar gjatë procesit të mësimdhënies element të EMI me nxënësit para ndërhyrjes së projektit:
 - a. Gjithomonë
 - b. Shpesh
 - c. Ndonjëherë
 - d. Asnjëherë
5. Sipas jush sa mendoni se keni aplikuar gjatë procesit të mësimdhënies element të EMI me nxënësit pas ndërhyrjes së projektit:
 - a. Gjithomonë
 - b. Shpesh
 - c. Ndonjëherë
 - d. Asnjëherë

6. Sipas jush sa mendoni që ju ka ndihmuar projekti në aftësitë për të:

	Ka ndihmuar shumë	Ka ndihmuar në nivel mesatar	Ka ndihmuar pak	Nuk ka ndihmuar fare
Përdorur median dhe informimin në kurrikulën shkollore				
Vlerësuar në mënyrë kritike tekstet e medias dhe burimet e informacionit				
Përzgjedhur burimet e duhura nga fusha e gjerë e materialeve që vijnë nga burimet e medias dhe të informacionit.				
Vlerësuar shkallën e të kuptuarit të EMI nga nxënësit				

7. Gjatë punës tuaj me nxënësit a keni planifikuar objektiva mësimorë që lidhem me përdorimin e medias para ndërhyrjes së projektit:
- Po
 - JO
8. Gjatë punës tuaj me nxënësit a keni planifikuar objektiva mësimorë që lidhem me përdorimin e medias pas ndërhyrjes së projektit:
- Po
 - JO
9. Nëse po, objektivat mësimorë që lidhen me median kanë qenë për
- Përdorimin e medias për të siguruar informacion shtesë
 - Përdorimin e medias për zhvillimin e aftësive të mendimit kritik
 - Përdorimin e medias për të shprehur në mënyrë krijuese qëndrimin e tyre.
 - Për të gjitha alternativat më lart
10. Cilat kanë qenë sfidat për integrimin e EMI në kurrikulën e arsimit parauniversitar:
- përdorimi i burimeve materiale mësimorë nga media
 - planifikimi i veprimtarive konkrete për përfshirjen e nxënësve në detyra që lidhen me EMI
 - planifikimi i strategjive dhe teknikave të edukimit për median dhe informimin në procesin mësimor
 - planifikimi i veprimtarive të veçanta që synojnë të vëzhgojnë arritjet e nxënësit në procesin e të nxënësit
 - Tjetër
 - Nuk ka pasur asnjë vështirësi
11. Cilat janë sfidat kryesore që ju hasni në procesin e mësimdhënies me fëmijët kur aplikoni elementë të EMI në shkollë?
- Orari dhe si është strukturuar ai
 - Mungesa e kohës për planifikim
 - Sfida e diskutimit të temave të ndjeshme në klasë
 - Vështirësi për përshtatjen e informacioneve sipas moshave
 - Mungesa e aksesit në internet, ose në teknologji

- f. Mungesa e njohurive/trajnimeve.
12. Mentorimi/supervizimi i ofruar nga profesionistët gjatë projektit:
- Ka qenë ndihmues për të kuptuar më shumë integrimin e EMI në orën e mësimit
 - Nuk kam përfituar nga mentorimi
 - Nuk më ka ndihmuar në aspektin profesional
 - Jam ndjerë nën presion nga prezenca e tyre në orën e mësimit
 - Tjetër _____
13. Çfarë mendoni që kanë përfituar nxënësit në fushën e EMI si rezultat i projektit:
- Njohuri më të mira për EMI
 - Aftësi për zgjidhjen e problemeve
 - Aftësi e të menduarit kritik
 - Tjetër _____
14. Bazuar në çfarë ndodhë vërtetë në klasë, çfarë qëllimesh arrijnë mësuesit gjatë mësimit ndërmjetës të EMI?
- mbrojtja e nxënësve nga ndikimi negativ i medias
 - vlerësimi kritik i medias
 - zhvillimi i aftësive të prodhimit mediatic
 - të kuptuarit e formave apo zhanreve të ndryshme mediatike
 - zhvillimi i aftësive të analizës së tekstit
 - largimi i nxënësve nga zakonet e këqija të konsumit të medias
 - kultivimi i një identiteti kulturor
 - Tjetër _____
15. Sa e shikoni EMI të rëndësishëm në procesin mësimor:
- Shumë i rëndësishëm
 - I rëndësishëm
 - Jo shumë i rëndësishëm
 - I pa rëndësishëm
16. Sipas mendimit tuaj:
- Trajnimet e EMI duhet të ofrohen për të gjithë mësuesit
 - EMI në shkollë duhet të përfshihet në të gjitha nivelet (d.m.th., fillestar, fillor dhe i mesëm)
 - Mësuesit duhet të përfshihen në trajnime të vazhdueshme për rritjen e kompetencave në këtë fushë
 - Tjetër _____

Guidë për intervista gjysëm të strukturuar

Instituti Shqiptar i Medias (ISHM) me mbështetjen e UNESCO dhe Bashkimit Evropian është duke zhvilluar një raport kërkimor që ka si qëllim mbledhjen e evidencave dhe identifikimin e rezultateve të arritura mbi Edukimin për Median dhe Informacionin në 20 shkollat pilotë ku është zbatuar projekti "Krijimi i besimit në media në Evropën Juglindore dhe Turqi, faza e II-të". Qëllimi i kësaj interviste është që të vlerësojë sesi ka ndihmuar projekti në rritjen e aftësive të rinjve për edukimin mbi Median dhe Informacionin (EMI) përmes integritit të kurrikulës së EMI-t të në sistemin edukativ formal në Shqipëri.

Ne garantojmë që i gjithë informacioni që ju do të na jepni gjatë bisedës do të jetë konfidencial, duke garantuar privatësinë tuaj.

Ju falenderojmë për pjesëmarrjen!

1. Si e kuptoni ju EMI (Edukimi për Median dhe Informacionin)
2. Përse u bëtë pjesë e këtij projekti për të integruar EMI-n në kurrikulat mësimore?
3. Cilat ishin rezultatet që arritët? Cilat aspekte të projektit vlerësoni më shumë?
4. Sa i nevojshëm ishte mentorimi? Si dhe sa ju shërbyeu? Cilat do ishin sugjerimet për të ardhmen për mentorimin për mësuesit për EMI-n?
5. Cilat janë sfidat kryesore në integrimin e EMI-t në kurrikulat mësimore?
6. Cilat janë disa nga mësimet e nxjerra? Si do të vepronit ndryshe?
7. Çfarë mendoni që ka ndryshuar në punën me fëmijët nga përfshirja e EMI në orën e mësimet?
8. A mund të përmendni ndonjë shembull ose praktikë të mirë?
7. Çfarë mendoni që duhet bërë më shumë në fushën e EMI?